

Direktivat SEVESO për kontrollin e rreziqeve të aksidenteve madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme

Më 10 korrik 1976 - Katastrofa Seveso - prodhim kimikatesh

Më 19 nëntor 1984 - Katastrofa e San Juanico, Mexico city - gaz i lëngshëm i naftës

Më 21 shtator 2001 - Tuluzë, Francë, plehra azotike

Më 13 maj 2000 - Enschede, Hollande Katastrofa - fishekzjarrë

2000 - Baia Mare, Rumani - Derdhja e cianurit

Më 1 nëntor 1986 - Zvicër - Derdhja kimike Sandoz

Më 11 Dhjetor 2005 - Zjarri Buncefield, Angli

Më 4 tetor 2010 – Katastrofa e Kolontár - uzina e aluminit në Ajka, Hungari

> 900 aksidente të mëdha që nga viti 1980

= Humbje miliarda € + viktima / lëndime + mjedis. Dëmtimi

Më 10 korrik 1976 - Katastrofa Seveso - prodhim kimikatesh

Ky ishte një aksident industrial që ndodhi, në një fabrikë të vogël të prodhimit kimik afërsisht 20 kilometra në veri të Milanos në rajonin e Lombardisë në Itali.

Ajo rezultoi në ekspozimin më të lartë të njohur ndaj 2, 3, 7, 8-tetraklorodibenzo-p-dioksinës (TCDD) në popullatat rezidenciale, e cila dha shkas për studime të shumta shkencore dhe rregullore të standardizuara të sigurisë industriale. Rregulloret e sigurisë industriale të BE-së njihen si Direktiva Seveso, e cila sot paraqitet në versionin e saj III, pas amendimeve që ka pësuar në vite si rezultat i ekspërjencës dhe mesiemve të nxjerra prej saj.

Në 2010, revista Time e renditi Seveson si katastrofa e tete më e keqe mjedisore e shkaktuar nga njeriu. Katastrofa u quajt Seveso sepse Seveso, me një popullsi prej 17,000 në 1976, ishte komuniteti më i prekur prej saj.

Ndërtesa e fabrikës ishte ndërtuar shumë vite më parë dhe popullata lokale nuk e perceptonte atë si një burim potencial rreziku, megjithëse kishin pasur disa ekspozime ndaj dioksinave.

Efektet e menjëhershme

Zona e prekur u nda në zonat A, B dhe R në rendin zbritës të përqendrimeve sipërfaqësore të TCDD në tokë. Zona A u nda më tej në 7 nën-zona.

- Popullata lokale u këshillua të mos prekte dhe të mos hante fruta ose perime të rritura në vend.
- Brenda pak ditëve, 3,300 kafshë, kryesisht shpendë dhe lepuj, u gjetën të ngordhura.
- Filloi thërja emergjente për të parandaluar hyrjen e TCDD në zinxhirin ushqimor dhe deri në vitin 1978 u theren mbi 80,000 kafshë.
- 15 fëmijë u shtruan shpejt në spital me inflamacion të lëkurës.
- Në fund të gushtit, Zona A ishte evakuuar dhe rrethuar plotësisht.
- Nga 1,600 njerëz të të gjitha moshave që ishin ekzaminuar, 447 u zbulua se vuani nga leziona të lëkurës ose cloracne.
- U krijua një qendër këshillimi për gratë shtatzëna, nga të cilat vetëm 26 vendosën për një abort (i cili ishte i ligjshëm në raste të veçanta) pas konsultës. 460 gra të tjera vazhduan shtatzëninë e tyre pa probleme, fëmijët e tyre nuk treguan ndonjë shenjë keqformimi.
- U arrestuan Drejtori Teknik dhe Drejtori i Prodhimit.
- U ngriten dy komisione qeveritare për të hartuar një plan për karantinimin dhe dekontaminimin e zonës, për të cilën qeveria italiane dha 47.8 milion dollarë amerikanë. Dy vjet më vonë kjo shumë u trefishua.
- Një studim i botuar në 1998 arriti në përfundimin se chloracne (gati 200 raste të lidhura me ekspozimin) ishte i vetmi efekt i vendosur me siguri. Hetimet e hershme shëndetësore duke përfshirë funksionin e mëlçisë, funksionin imunitar, dëmtimin neurologjik dhe efektet riprodhuese dhanë rezultate jo përfundimtare.
- U zbulua një shkallë e rritur e vdekshmërisë nga sëmundjet kardiovaskulare dhe të frymëmarrjes, dhe tejkalim i rasteve të diabetit. Rezultatet e incidencës së kancerit dhe


ndjekjes së vdekshmërisë treguan një rritje të shfaqjes së disa llojeve të kancerit. Por rezultatet nuk u konsideruan përfundimtare ose gjithëpërfshirëse, për shkak të disa kufizimeve të studimit.

- Në janar 1977, u përfundua një plan veprimi me analiza shkencore, ndihmë ekonomike, monitorim mjekësor dhe restaurim / dekontaminim. Kompania filloi menjëherë të paguante kompensimet e para për të prekurit. Më vonë, filluan operacionet e dekontaminimit pranveror dhe në qershor filloi një sistem monitorimi epidemiologjik i shëndetit për 220,000 njerëz. Ata më pas përdorën triklorofenol për të bërë një ilaç për të luftuar infeksionet e lëkurës, të cilin e testuan tek qentë.
- Në qershor 1978, qeveria italiane ngriti huanë e saj të veçantë nga 47.8 deri 137.5 mln USD. Deri në fund të vitit, shumica e kërkesave për kompensim ishin zgjidhur jashtë gjykatës.
- Më 19 dhjetor 1980, përfaqësuesit e Rajonit të Lombardisë dhe kompanise, në prani të kryeministrit të Italisë nënshkruan një marrëveshje kompensimi prej 23.9 ml USD.
- Mbeturinat nga pastrimi i impiantit ishin veshjet mbrojtëse dhe mbetjet kimike nga impianti. Këto u paketuan në fuci që perdoreshin për ruajtjen e mbetjeve bërthamore. U ra dakord që mbeturinat të asgjeshohen sipas ligjit.
- Në Shtator 1983, Gjykata Penale e Monzës dënoi pesë ish-punonjës të kompanisë me dënime me burg që varionin nga 2.5 vjet në 5 vjet.
- Shumë shpejt u pranua që sistemet e sigurisë të fabrikës ishin fare elementare dhe ishin hartuar duke pasur parasysh thujtë vetem parandalimin e shpërthimit të thjeshtë. Mbrojtja e mjedisit nuk ishte konsideruar fare. As nuk ishte dhënë ndonjë konsideratë për vendosjen e ndonjë sistemi paralajmërues ose protokolleve të mbrojtjes shëndetësore për komunitetin lokal. Si rezultat, kur ndodhi aksidenti, popullata lokale u gjet e papergatitur për të përballuar rrezikun e një helmi të padukshëm.
- Në kontekstin e tensioneve të tilla të shtuara, Seveso u bë një mikrokozmos ku pasqyroheshin të gjitha konfliktet ekzistuese të shoqërisë (politike, ndermarrjeale, fetare, industriale). Sidoqoftë, brenda një kohe relativisht të shkurtër, këto konflikte u qetësuan dhe komuniteti vazhdoi të rimëkëmbej. Sepse, në Seveso, pala përgjegjëse ishte e njohur që nga fillimi dhe shume shpejt ofroi dëmshpërblim. Për më tepër, largimi i fabrikës dhe eksportimi fizik i substancave toksike dhe i tokës së ndotur i mundësuan komunitetit të ndihej i pastruar. Zgjidhja e pasojave emocionale të traumës, aq e nevojshme për rimëkëmbjen e një komuniteti, u lehtësua nga këto veprime".
- Trajtimi i tokës në zonat e prekura tani konsiderohet i plotë, pasi nivelet e dioksinës tani janë nën nivelin natyral. E gjithë zona është kthyer në një park publik. Kjo zonë është përgjithmonë jashtë kufijve të zhvillimit. Parku ka dy kodra artificiale, nën të cilat janë mbetjet toksike (përfshirë shtëpitë e shkatërruara, tonelata toke të ndotur dhe mbetje kafshësh), të gjitha të mbrojtura në një kapsule prej betoni. Hetimet në kushtet e vendit kanë konfirmuar që jetëgjatësia e nevojshme dhe e pritshme e kapsules prej 300 vjetësh, është e përshtatshme.
- Jane përfunduar disa studime mbi shëndetin e popullatës së komuniteteve përreth. Ndërsa është vërtetuar se banoret e Sevesos të ekspozuar ndaj TCDD janë më të ndjeshëm ndaj disa kancereve të rralla. Kur të gjitha llojet e kancereve grupohen në një kategori, ende

nuk është raportuar ndonjë rritje statistikisht e rëndësishme në ndonjë kategori specifike të kancerit. Kjo tregon se nevojiten më shumë kerkime për të përcaktuar efektet e vërteta shëndetësore afatgjata mbi popullatën e prekur.

- U krijuan programet e monitorimit epidemiologjik si më poshtë (me datat e përfundimit): abortet (1982); keqformimet (1982); tumoret (1997); vdekjet (1997). Monitorimi shëndetësor i punëtorëve të ndërmarrjeve dhe të projekteve të dekontaminimit, dhe të sëmurëve me kloracne (1985).
- Në 1982 Komuniteti Evropian miratoi Rregulloret e Sigurisë Industriale të quajtur Direktiva Seveso, e cila imponoi rregulla shumë më të forta për industrinë. Direktiva Seveso u azhurnua në 1996, 2008 dhe 2012 dhe aktualisht referohet si Direktiva Seveso III.

Seveso - Cloracne



Më 19 nëntor 1984 - Katastrofa e San Juanico, Mexico city - gaz i lëngshëm i naftës

Kjo ishte një katastrofë industriale e shkaktuar nga një seri masive shpërthimesh në një rezervuar me (LPG) në San Juanico (ne te dale te Mexico City, Meksikë). Shpërthimet konsumuan 11,000 m³ LPG, që përfaqëson një të tretën e furnizimit me gaz të lengezuar te naftës të Mexico City. Shpërthimet shkatërruan objektin dhe qytetin, me 500-600 njerëz të vrarë, dhe 5000-7000 të tjerë me djegie të rënda. Katastrofa e San Juanico ishte një nga katastrofat industriale më vdekjeprurëse në historinë botërore.



Më 21 shtator 2001 - Tuluzë, Francë, plehra azotike

Ndodhi një shpërthim në fabrikën e plehrave azotike. U depozituan 300 ton nitrat amoni (kapaciteti maksimal ishte 2,000 tonë) në hangarin # 221 metra. Brezat prej çeliku u gjetën 3 kilometra larg shpërthimit. Shpërthimi u mat në graden 3.4 ne shkallën Rihter dhe u dëgjua deri 80 km larg. Në fillim policia besoi se të paktën pesë bomba kishin shpërthyer në të njëjtën kohë. Ende ka polemikë mbi numrin e saktë të shpërthimeve.

Fabrika ishte afër qytetit: një nga zonat më të banuara është 1 kilometër larg. Disa shkolla, një kampus universitar, një spital i përgjithshëm dhe një spital psikiatrik u detyruan të evakuohen.

Katastrofa shkaktoi 31 vdekje, rreth 30 të plagosur rëndë dhe 2.500 viktima të lehta. Dy të tretat e dritareve të qytetit u thyen, duke shkaktuar 70 plagë në sy. Dëmet totale të paguara nga grupet e sigurimeve tejkaluan 1.5 miliardë euro.

Më 13 maj 2000 - Enschede, Hollande Katastrofa - fishekzjarrë

Katastrofa u shkaktua nga një shpërthim që ndodhi në depon e fishekzjarrëve. Një zjarr çoi në një shpërthim të madh i cili vrau 23 vetë, përfshirë katër zjarrfikës dhe plagosi gati 1.000. 400 shtëpi u shkatërruan dhe 1,500 ndërtesa u dëmtuan. Shpërthimi më i madh u ndie deri në 30 kilometra larg. Ekipet e zjarrfikësve u thirrën nga përtej kufirit në Gjermani për të ndihmuar në luftimin e zjarrit; ajo u vu nën kontroll deri në fund të ditës.

Para katastrofës S.E. Fishekzjarre kishte një rekord të mirë të sigurisë dhe plotësonte të gjitha kontrollet e sigurisë.

2000 - Baia Mare, Rumani - Derdhja e cianurit

Derdhja e cianurit në lumin Someş nga nje kompani minierash të arit. Ujërat e ndotur arritën në lumin Danub, duke vrarë një numër të madh peshqish në Hungari, Serbi dhe Rumani. Derdhja është quajtur katastrofa më e rëndë mjedisore në Evropë që nga katastrofa e Çernobilit.

Më 1 nëntor 1986 - Zvicër - Derdhja kimike Sandoz

Kjo ishte një katastrofë e madhe mjedisore e shkaktuar nga një **zjarr në nje magazinën agrokimike**, e cila lëshoi agrokimikate toksike në ajër dhe rezultoi në tonelata ndotësish që hynë në lumin Rhine, duke e ngjyrosur atë në të kuq. Kimikatet shkaktuan një vdekshmëri masive të jetës së egër në rrjedhën e poshtme, duke vrarë, midis kafshëve të tjera, një pjesë të madhe të popullsisë së ngjalave evropiane në Rhine. Situata u rikuperua brenda dy viteve. Si pasojë e incidentit, Sandoz zgjeroi aktivitetet e saj të shëndetit, sigurisë dhe mjedisit dhe prezantoi procedura të reja për menaxhimin e rrezikut dhe emergjencës, përfshirë auditimin e ketij menaxhimi.

Më 11 Dhjetor 2005 - Zjarri Buncefield, Angli

Ky ishte një zjarr i madh në një **depo naftembajtëse** në Hertfordshire Oil Storage Terminal, afër nje autostradës në Hertfordshire, Angli. Terminali ishte depoja e pestë më e madhe e magazinimit të produkteve të naftës në Mbretërinë e Bashkuar, me një kapacitet prej rreth 273 milion litra karburant.

Më 4 tetor 2010 – Katastrofa e Kolontár - uzina e aluminit në Ajka, Hungari

Një aksident industrial në një zinxhir të rezervuarëve të mbetjeve kaustike ndodhi në uzinën e aluminit në Ajka, në Hungari. Diga e rezervuarit numer 10 u shemb, duke çliruar afërsisht një milion metra kub mbetje të lëngët nga liqenet me balta të kuqe. Balta u lëshua si një dallge 1-2 m duke përbytur disa lokalitete aty pranë, përfshirë fshatin **Kolontár** dhe qytetin e Devecser. Dhjetë vetë vdiqën dhe 150 njerëz u plagosën. Fillimisht u prekën rreth 40 kilometra katrorë tokë. Në 7 Tetor 2010 ndotja arriti në Danub.

Historia e legjislacionit të BE për Rregullat e Sigurisë Industriale

1982 – Seveso I (pas ngjarjes në Seveso, Itali)

1996 – Seveso II (pas katastrofes në Bhopal - rrjedhje kimike në 1984 - Në atë kohë, ai u quajt aksidenti më i keq industrial në histori); Mexico city

2003 – Amendimi i Seveso II (pas ngjarjes në Toulouse Enschede Baia Mare)

2012 – Seveso III (u lidh me GHS - Globally Harmonized System of Classification and Labelling of Chemicals)

1 qershor 2015 - përfundoi periudha e transpozimit për Seveso III

Direktiva Seveso III

Ndikimet e aksidenteve të mëdha

Ndikimet mbi Ndermarrjet:

- **Dëmtim i drejtpërdrejtë:** Brenda dhe jashtë ndermarrjes & Dëm strukturor & Dëm mjedisor
- **Kosto mbi biznesin:** Nderprerja e biznesit / Falimentimi & Kompensimet & Çështjet gjyqësore
- **Dëmtim i imazhit:** Humbja e besimit nga komuniteti dhe autoritetet tek aksioneret & kontrolle më të forta

Ndikimi mbi autoritetet / komunitetet:

- **Shëndeti i njeriut:** Fatalitete dhe lëndime (fizike dhe psikologjike)
- **Kosto e reagimit:** Shërbimet emergjente & Evakuimi & Devijimi dhe ngadalsimi i trafikut
- **Kostot në vijim:** Kosto për autoritetet për të ndjekur situatën, rehabilitimin, largimin e ndotjes së shkaktuar / pastrimin e burimeve ujore të ndotura

Ndikime të tjera: Ndikime socio-ekonomike:

- humbja e vendeve të punës
- humbja e të ardhurave të bizneseve të lidhura me biznesin e ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, etj.
- ndikimi politik (humbja e besimit ndaj aftësive të autoriteteve dhe politikës, etj.)

SEVESO II 96/82 / EC

Objektivi: të parandalojë aksidentet e mëdha dhe të kufizojë pasojat e tyre.

Fusha e veprimit: bazuar në sasinë e substancave të rrezikshme të pranishme në ndermarrje (emërtuar substancat e percaktuara dhe substanca që përfshihen në klasifikime të caktuara të rrezikut të BE - shëndeti / eksplozivët / mjedisi):

- **Mbulon kryesisht** industrinë kimike dhe petrol-kimike, magazinimin, prodhimin industrial dhe impiantet e prodhimit të energjisë
- Vendos **pragje** për tonazhin e substancave të rrezikshme në ndermarrje
- Vendos kërkesa **proporcionale** me rrezikun

Qasja me 2 nivele:

- Ndërmarrjet e nivelit të sipërm dhe
- Ndermarrje të nivelit të ulët
- Ndermarrjet e nivelit të sipërm u nënshtrohen kërkesave më të rrepta.
- ~ 10,000 ndermarrje/ ndermarrje në vendet e BE, 45% të nivelit të lartë

SEVESO II --- Seveso III - Evolucion, jo revolucion

SEVESO III 2012/18 / EU - Ndryshimet kryesore

- **Përshtatja ndaj Sistemit të Harmonizuar Globalisht (GHS) për kimikatet**
 - Lidhja e fushës së veprimit të Direktives me klasifikimin e ri ndërkombëtar të kimikateve (Rregullorja 1272/2008/EC CLP për transpozimin e klasifikimit GHS)
- **Forcimi i nivelit të mbrojtjes dhe sqarimeve**
 - Disa përjashtime nga fusha e veprimit (neni 2) dhe disa sqarime mbi përkufizimet (neni 3)
 - Politika e Parandalimit të Aksidenteve të Mëdha - mjet i ri parandalues
 - **Efekti domino**
 - Të drejtat e qytetarëve të përmirësuara (pjesëmarrja / informacioni / aksesimi në drejtësi)
 - Inspektimet

Një efekt domino ose reaksion zinxhir është efekti kumulativ i prodhuar kur një ngjarje sjell një zinxhir ngjarjesh të ngjashme. Termi njihet më mirë si një efekt mekanik dhe përdoret si një analogji me rënien e gureve të dominose të mbeshetur te njëri tjetri.

Direktiva Seveso III (2012/18 / BE) synon parandalimin e aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme. Sidoqoftë, meqë aksidentet mund të ndodhin pavarësisht masave parandaluese, Direktiva synon gjithashtu të kufizojë pasojat e tyre jo vetëm për shëndetin e njeriut, por edhe për mjedisin.

Direktiva përfshin ndermarrjet ku substancat e rrezikshme mund të jenë të pranishme (p.sh. gjatë përpunimit ose ruajtjes) në sasi që tejkalojnë pragun e caktuar.

Përjashtohen nga Direktiva disa aktivitete industriale që i nënshtrohen një legjislacioni tjetër duke siguruar një nivel të ngjashëm të mbrojtjes (p.sh. ndermarrjet bërthamore ose transporti i substancave të rrezikshme).

Kuadri ligjor i vendosur nga Direktiva krijon një cikël përmirësimi të vazhdueshëm të parandalimit, gatishmërisë dhe reagimit ndaj aksidenteve të mëdha. Cikli mbyllet nga dispozitat për nxjerrjen e mësimave nga përvojat.

- **Shtylla e parë: Parandalimi**
- **Shtylla e dytë: Gatishmëria**
- **Shtylla e tretë dhe e katërt: Reagimi dhe mësimet**

Shtylla e parë: Parandalimi. Përcaktohen detyrimet për operatorët dhe autoritetet për parandalimin e aksidenteve të mëdha

Detyrimet e Operatorit

Te përgjithshme: Të marre të gjitha masat për të (Art. 5):

- Parandaluar aksidentet
- Kufizuar ndikimet e aksidenteve

Specifike:

- Njoftuar ndermarrjet (neni 7)
- Hartuar politiken e parandalimit të aksidenteve të mëdha (neni 8)
- Ngritur sistemin e menaxhimit të sigurisë (neni 8 & shtojca III)
- Hartuar Raportin e Sigurisë (*ndermarrjet e nivelit të lartë*) (neni 10)

Detyrimet e Autoriteteve

- Planifikimi i përdorimit të tokës, përfshirë efektin domino (neni 13)
- Inspektimet (neni 20)

Politika e Parandalimit të Aksidenteve Madhore dhe Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë

Art.8 - përcakton qëllimet e përgjithshme të operatorit dhe parimet e veprimit, rolin dhe përgjegjësitë e menaxhimit, angazhimin për të vazhduar përmirësimin, kontrollin e aksidenteve të mëdha, zbatimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë bazuar në Aneksin III dhe në proporcion me rreziqet e aksidenteve të mëdha në rrezik dhe kompleksitetin e organizatës / aktiviteteve të ndermarrjes.

Ndermarrjet e nivelit të ulët mund ta zbatojnë me mjete të tjera të përshtatshme, duke marrë parasysh edhe Aneksin III.

Raporti i Sigurisë

Art. 10 - vetëm për ndermarrjet e nivelit të sipërm duhet të përmbajë informacion mbi:

- Mjedisi i ndermarrjes
- përshkrimi i impjantit - substancat
- analiza e rrezikut dhe metodat e parandalimit

- masat për të kontrolluar pasojat e një aksidenti - plani i brendshëm i emergjencës

Efekti Domino

Arti 9 - Autoriteti kompetent të identifikojnë efektin domino përfshirë edhe kërkimin aktiv të informacionit shtesë nga operatorët dhe informimin e operatorët të interesuar

Arti 20 - plani i inspektimit të përfshijë listat e ndermarrjeve me efekt potencial domino

Shtojca IV (2) (e): efekti domino të konsiderohet edhe në planet e jashtme të emergjencës

Planifikimi i Përdorimit të Tokës - Art 13

- Autoritetet kompetente për përdorimin e tokës të marrin parasysh nevojën për të ruajtur **distancat e duhura të sigurisë** midis ndermarrjeve dhe p.sh. zonave të banuara ose zonave natyrore sensitive dhe të zbatojnë masa teknike shtesë për ndermarrjet 'ekzistuese'
- Për ta bërë këtë, autoritetet kompetente duhet të sigurojnë që operatorët të ofrojnë **informacion të mjaftueshëm mbi rreziqet** (niveli më i ulët kur i kërkohej)
- **Publiku i interesuar** të konsultohet (Neni 15), kur planifikohet ngritja e qendrave të reja
- Te behet i mundur koordinimi me procedurat e VNM dhe VSM.

Inspektimet - Art 20

Plani i inspektimit (kombëtar, rajonal ose lokal) që përfshin të gjitha ndermarrjet duhet të përmbajë informacion mbi:

- vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë
- informacione mbi efektet domino
- informacion mbi rreziqet / e veçanta të jashtme
- procedurat për inspektimet rutinë / jo-rutinë
- bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të inspektimit
- Mbi këtë bazë, autoriteti kompetent përcakton programe për inspektime rutinë, përfshirë frekuencën e vizitave në terren

Inspektimet - Art 20

Frekuenca:

- 1 here ne vit (niveli i sipërm) / 1 here ne 3 vjet (niveli i poshtëm)
- Në qoftë se autoriteti kompetent nuk përcakton program inspektimi, frekuenca e inspektimit bazohet në vlerësimin sistematik të rreziqeve të aksidenteve të mëdha, ku vlerësohen (1) ndikimi i mundshëm në shëndet dhe mjedis dhe (2) rreziku i mosrrepspektimit.

Konkluzione për operatorin brenda 4 muajve - veprim!

- Asnjë veprim nuk mund të çojë në ndalim / mbyllje të aktivitetit
- Inspektim shtesë nëse ka shkelje serioze

Shtylla e dytë: Gatishmëria

Detyrimet e Operatorit

- Plani i brendshëm i emergjencës (neni 12) (për ndermarrjet e nivelit të lartë)
- Trajnimi i stafit
- Konsultimi me stafin (për ndermarrjet e nivelit të lartë)
- Informimi i publikut

Detyrimet e Autoriteteve

- Plani i jashtëm i emergjencës (neni 12)
- Informimi dhe përfshirja e publikut
- Informimi i vendeve fqinje

Publiku

- Konsultimi dhe pjesëmarrja e publikut (neni 15):
- Planifikimi
- Modifikimet
- Plani i emergjencës
- Aksesimi në drejtësi dhe në informacion (Art. 14, 22, 23)

Mjetet e kontrollit të dëmtimit

Planet e brendshme të emergjencës

Duhet rishikuar / testuar, rishikuar / azhurnuar nga Operatori (minimumi çdo 3 vjet) konsultimi i personelit dhe informimi i publikut

Planet e jashtme të emergjencës

Duhet rishikuar / testuar / rishikuar / azhurnuar nga Autoriteti Kompetent (minimum çdo 3 vjet) konsultimi i popullatës dhe informimi i publikut

Shtylla e tretë dhe e katërt: Reagimi dhe mësimet

Detyrimet e Operatorit

- Te japë informacion
- Përgjegjësia: të zbuti efektet

- Te parandaloje përsëritjen

Detyrimet e Autoriteteve

- Te aktivizojne planin e emergjencës
- Te bëjne informacionin të disponueshëm për publikun
- Te monitorojne zbutjen e efekteve
- T'i raportojne Komisionit Evropian

Detyrimet e Komisionit

- Te analizoje të dhënat e raportuara
- Te bëje të disponueshme të dhënat e raportuara
- Te evidentojë mësimet e nxjerra nga eksperiencia

Informacioni - Art 14

- Publiku të informohet në mënyrë aktive për sjelljen e nevojshme në rast aksidenti
- Informacioni i kërkuar nga Shtojca V e Direktives të jetë i disponueshëm në mënyrë permanente (tipi i ndermarrjes, rreziku që bart, veprimet që duhen ndërmarrë kur ndodh aksidenti)
- Raporti i sigurisë dhe inventarizimi i substancave të rrezikshme të jetë i disponueshëm kur kërkohet
- Te informohen shtetet e tjera anëtare në rast të efekteve të mundshme ndërkufitare

Informimi - Aneksi V

Ne të gjitha ndermarrjet - Informacioni i kërkuar nga Aneksi V – të jetë i disponueshëm në mënyrë elektronike në mënyrë të përhershme:

- sjellja e duhur në rast aksidenti
- vizita e fundit në vend (inspektimi) ose informacioni se ku mund të merret më shumë informacion me kërkesë
- Informacion mbi substancat e rrezikshme

Niveli i sipërm (p.sh.)

- informacion mbi skenarët kryesorë të aksidenteve dhe masat për adresimin e tyre
- informacion nga planet e jashtme të emergjencës për t'u marrë me ndikimet jashtë vendit

Pjesëmarrja publike - Art 15

Art 12 (5) - publikut të interesuar duhet t'i jepet që heret mundësia për të dhënë mendimin e vet për planet e jashtme të emergjencës

Art 15

- Vendos rregulla të hollësishme procedurale për pjesëmarrjen e publikut të interesuar në lidhje me cdo project
- I referohet Direktivës 2003/35 / EC (pjesëmarrja e publikut në planet dhe programet me efekt ne mjedis) për pjesëmarrjen e publikut te planet dhe programet paraardhëse të ndermarrjeve që bien ne kuadrin e directives SEVESO
- **Autoritetet kompetente marrin parasysh komentet dhe argumentojnë vendimin përfundimtar dhe informojnë publikun**

Aksesi në drejtësi - Art 23

- Rishikimi administrativ dhe gjyqësor i veprimeve / mosveprimeve në lidhje me kërkesat për çdo informacion të mbajtur si kerkese e Direktivës Seveso
- Të paktën rishikimi gjyqësor i veprimeve / mosveprimeve në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në projekte
- Aksesi në drejtësi në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në planet dhe programet e përgjithshme / planet e jashtme të emergjencës, nëse parashikohet sipas ligjit kombëtar.

Direktiva Seveso III eshte transpozuar pjeserisht ne legjislacionin Shqiptar permes Ligjit nr. 45/2019 “PËR MBROJTJEN CIVILE”